



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, më 17.5.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S- II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Danush Ademi.

Munguan: Rexhep Selimi, Ganimete Musliu dhe Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE- ja; Dhurata Kryeziu, OSBE; Visar Rushiti, GAP; Blerta Bejtullahu, Zyra e BE-së- Kosovë, Naim Hajdari, EULEX, Sanije Berisha, OSBE, Luanda Domi, DCAF.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur, më 30.4.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173, për Përgjimin e Telekomunikimeve ;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 30.4.2013

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30.4.2013 u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173, për Përgjimin e Telekomunikimeve.

Kryetari i Komisionit- Ju njoftoj se si grup punues jemi angazhuar, bashkë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe mekanizmat e tjerë, që ndërlidhen me procesin për përgjimin e telekomunikimeve. Nga të gjitha konsultimet e bëra, ka rezultuar që Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve të dërgohet në seancë, duke qenë se e kemi obligim si Komision, dërgimin e tij për aprovim në lexim të parë.

Për shkak se Projektligji ka pasur shumë vërejtje, si nga Komisioni, po ashtu edhe nga mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, ekziston një dallim në Komision, pasi një pjesë është që Projektligji të dërgohet në seancë plenare dhe të amendamentohet, ndërsa pjesa tjetër, është që seanca plenare të vendosë, për kthimin e këtij Projektligji në Qeveri, nëse ai ka nevojë që të përpunohet.

Pasi për këtë çështje, ka dallime në Komision, konsideroj se duhet ta dërgojmë Projektligjin në seancë, ndërsa në rast se keni diçka për të shtuar për këtë çështje, ju ftoj ta merrni fjalën.

Anton Quni- Pasi projektligji për përgjimet e telekomunikimeve është shqyrtuar nga Komisioni dhe ekspertë të caktuar, çështja që më shqetëson është, që ky Projektligj nuk e siguron mbikëqyrjen demokratike dhe në mungesë të kësaj, krijohet mundësia e keqpërdorimit.

Për këtë arsye, qëndrimi ynë ka qenë, që ky Projektligj ti kthehet Qeverisë, pasi ka nevojë për ndryshime esenciale, dhe në momentin kur të sigurojmë kontrollin demokratik nga cilido Komision që mund të mbulojë këtë fushë, pastaj mund të diskutohet për detaje të tjera të këtij Projektligji.

Fatmir Xhelili- Diskutimet rreth Projektligjit për përgjimet, kanë shërbyer për të kuptuar më mirë fushën që mbulon ky Projektligj, për të gjithë ata që nuk janë të familjarizuar me çështjen e përgjimeve.

Theksoj që sistemi për përgjimet është duke funksionuar, ndërsa argumentet ligjore dhe mbrojtja ligjore për materialin, i cili përdoret nga produktet e përgjimit, është i kontrolluar nga Gjykata dhe është i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, në të cilin

përcaktohet, që asnjë provë nuk merret parasysh, pa lejen e gjykatësit për përgjime dhe kjo është mbrojtje e mirë për qytetarët.

Ndërsa sa i përket mbikëqyrjes së përgjimeve, në Kodin e Procedurës Penale sigurohet mbikëqyrja nga komisionet adekuate të Kuvendit të Kosovës, ndërsa tre mangësitë që ka projektligji për përgjimin e telekomunikimeve, që për qëllim ka përcaktimin e procedurave të ruajtjes së produkteve të përgjimeve dhe mbrojtjen e privatësisë të subjekteve të përgjuara, kjo materie ka bërë që ky projektligj të jetë i diskutuar.

Pajtimi i Komisionit që të jenë dy qendra elektronike ku materiali merr lejen për tu përgjuar dhe kontrolli ligjor që rrjedh nga Ligji për AKI-në, duke shtuar edhe nenin, i cili do të garantonte mbikëqyrjen nga Komisioni, do të bënte që ky ligj të ishte funksional. Pajtohem që ligji të kalon në lexim të parë, me gjithë kundërthëniet që ekzistojnë në disa pika të këtij projektligji, dhe se pas punës së një grupi punues profesional do të nxirret një ligj funksional dhe që do të garantonte privatësinë e qytetarëve.

Goran Marinković- Pajtohem që Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve është i ndjeshëm dhe ka nevojë për plotësime, ka mangësi gjë e cila është thënë edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë.

Përkrah vendimin e shumicës së anëtarëve të Komisionit për procedimin e tij në seancë plenare dhe në seancë të vendosët për hapat e mëtejshëm, pasi ky ligj është i ndjeshëm dhe prek privatësinë e qytetarëve.

Vjollca Krasniqi- Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve, ka dy muaj që është në shqyrtim në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si i tillë nuk ka pasur mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit. Është themeluar grupi punues i cili është konsultuar me mekanizmat relevant për projektligjin.

Për këtë projektligj ekzistojnë kundërthënie mes anëtarëve të Komisionit në disa pika esenciale, dhe mendimi im është që ky projektligj të mos procedohet si i tillë. Pasi si Komision nuk mund ta kthejmë, i mbetet seancës që të vendos më tutje.

Danush Ademi- Vërejtjet e bëra për projektligjin për përgjimet, nuk janë paraqitur me shkrim, prandaj do të ishte mirë t'i kishim vërejtjet dhe ndërhyrjet që janë bërë nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit- Grupi punues që është marrë me shqyrtimin e projektligjit për përgjimet, nuk ka bërë përpunimin e tij por vetëm ka realizuar takime konsultative, duke përfshirë edhe institucionet, të cilat do të mund të kontribuonin. Takimi i fundit në kuadër të kësaj faze ka qenë takimi me Drejtorin e AKI-së, z. Bashkim Smakaj, i cili ka paraqitur disa rekomandime me shkrim.

Me që në bazë të rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, e kemi obligim dërgimin e projektligjit në seancë plenare. Gjithashtu, konsideroj se nuk janë vetëm tre elemente në të cilat ka pasur mospajtime, por duhet të ndërhyjmë në çdo nen, pasi ka dallim prej asaj se çfarë përmban projektligji aktual i propozuar dhe përpunimi që do të bëhet në të ardhmen.

Prandaj, nëse pajtoheni projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve do të mund ta dërgonim në seancë plenare për miratimin e tij në lexim të parë, ndërsa seanca vendos për hapat e mëtejshëm, nëse ka nevojë për përpunim të mëtejshëm ose për kthimin e tij në Qeveri.

A jeni dakord që ta dërgojmë projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve në seancë, me rekomandimin që në seanca të vendosë për procedimin apo kthimin e tij në Qeveri?

Në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me votim të unanime mori këtë

VENDIM

Projektligji 04/L-173 për Përgjimin e Telekomunikimeve, procedohet për shqyrtim të mëtejshëm në seancë plenare.

4. Të ndryshme.

Danush Ademi- Theksoi se në komunikacion veturat e tipit “pikap” e vështirësojnë punën e komunikacionit, duke vlerësuar se për këtë duhet të bëhet shkresë policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit-

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 10:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi